



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 14 qershor 2013

**Eveniment për shënimin e fillimit të projektit të financuar
nga BE-ja dhe Këshillit të Evropës:**

**"Ndërtimi i kapaciteteve të agjencive për zbatimin e ligjit
për trajtim të drejtë të personave të paraburgosur dhe të
burgosur"**

(Hotel Holiday Inn)

Fjalim i
Ambasadorit të BE-së
Shef i Delegacionit të BE-së

E nderuara Ministresh znj. Jankulovska,
I nderuari Ministër Bexheti,
E nderuara znj. Taylor,
Zonja dhe zotëri,

Është nderë për mua që sot e shënojmë fillimin e projektit të financuar nga BE-ja synimi i të cilit është ta përmirësoj trajtimin e personave të paraburgosur dhe të burgosurit, së bashku me Ministrinë e punëve të brendshme dhe Ministrinë e drejtësisë, dhe Këshilli i Evropës.

Ky projekt do të siguroj ndihmë të drejtpërdrejtë për avancimin e praktikave dhe rregullave në stacionet policore dhe në burgjet. Një ekip të ekspertëve ndërkombëtarë dhe nacional do të punojnë së bashku me trupat nacionale për zbatimin e ligjit për forcimin e kapaciteteve drejtuese dhe për respektimin e të drejtave njerëzore.

Projekti, gjithashtu duhet të nxis kuptim ndaj situatave specifike të personave të burgosur dhe paraburgosur, e me këtë të përmirësojnë kushtet e tyre në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Në fund, ky projekt i financuar nga BE-ja duhet të siguroj që vendi të jetë në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës

Evropiane për të drejtat e njeriut dhe me rekomandimet e Komitetit për parandalimin e torturës të Këshillit të Evropës.

Ne e përshëndesim angazhimin e Ministrisë për punë të brendshme dhe të drejtësisë, si dhe të Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve si dhe të Sektorit për kontrole të brendshme të policisë, për plotësimin e rekomandimeve të Komitetit për parandalimin e torturës të Këshillit të Evropës.

Mekanizmi nacional për parandalimin e torturës është një vegël e rëndësishme për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit. Megjithatë, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për rritjen e njohurive ndaj standardeve evropiane, për përmirësimin e kushteve dhe zbatimin e masave për mbrojtje nga keqtrajtimit në stacionet policore dhe në burgjet.

Zona dhe zotëri,

Besoj se me këtë projekt, Bashkimi Evropian do ti avancoj kapacitetet e agjencive për zbatimin e ligjit dhe kjo do ta përmirësoj mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe vlerave demokratike.

Të gjithë partnerëve u dëshiroj shumë sukses gjatë implementimit të projektit!

Ju falënderohem për vëmendjen tuaj.